



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 qershor 2015
Nr. ref.: RK 805/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI132/14

Parashtrues

Rrok Nikollprenkaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në
Gjakovë, P. nr. 389/12, të 21 gushtit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rrok Nikollprenkaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Novosellë e Epërme, komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, P. nr. 389/12, të 21 gushtit 2012, i cili i ishte dorëzuar atij më 21 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar cilat dispozita kushtetuese pretendohen të jenë shkelur me vendimin e kontestuar. Në kërkesën e tij parashtruesi deklaroi se *“I kërkoj të drejtat e mija ku tallen gati prej 5 viteve nga ana 4 persona ne fjal dhe gjyqësis.”* Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ka pasur *“shkelja e autoritetit Prekuroria deri te gjyqtarija pas rastit 25.04.2010; 26 26.04.2010 qillimisht ishin shmangur rastit gjat paraburgimit duke me akuzuar per tme burgos qe të mbyllet rasti”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 gusht 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata)
6. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 15 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 16 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 25 prill 2010, 4 (katër) policët në fjalë arrestuan parashtruesin e kërkesës.
10. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjatë arrestimit ai ishte rrahur nga këta policë dhe si pasojë ai ka pësuar dëmtime të rënda të trurit.
11. Më 26 prill 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktvendimin (Hp. nr. 32/2010) kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni. 317.2 i Kodit të Përkohshëm Penal, KPPK). Me atë Aktvendim parashtruesit të kërkesës i ishte

caktuar masa e paraqitjes në stacionin policor. Statusi i mëtejshëm i këtij rasti është i panjohur.

12. Më 5 tetor 2010, Prokuroria Publike Komunale në Gjakovë, e njoftoi parashtruesin e kërkesës se kishte pushuar hetimin kundër 4 (katër) policëve për veprat penale: 1) lëndim i rëndë trupor, 2) privim të kundërligjshëm nga liria, dhe 3) keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave. Parashtruesi ishte njoftuar se ai mund të ndërmarrë ndjekje penale sipas padisë private, në pajtim me nenin 62.2 të KPPK-së.
13. Më 22 mars 2011, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi private në Gjykatën Komunale në Gjakovë, kundër 4 (katër) oficerëve të policisë për 4 (katër) vepra penale: 1) lëndim i rëndë trupor, 2) privim të kundërligjshëm nga liria, 3) keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave, dhe 4) torturë.
14. Kjo padi u hodh poshtë më 15 korrik 2011 me Aktvendimin (P nr. 275/11) të Gjykatës së Qarkut në Pejë. Arsyetimi ishte se parashtruesi i kërkesës nuk është prokuror i autorizuar për këto katër vepra penale, ndjekja e të cilave është nën autoritetin e Prokurorit të Shtetit.
15. Parashtruesi i kërkesës nuk parashtrroi ankesë ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.
16. Më 16 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi private në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër katër oficerëve të policisë për veprat penale: 1) lëndim i rëndë trupor, 2) privim të kundërligjshëm nga liria, dhe 3) keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave.
17. Më 21 gusht 2012, padia e tij private ishte refuzuar dhe ishte pushuar procedura penale nga Gjykata Komunale në Gjakovë, me Aktvendimin, P. nr. 389/12. Në arsyetimin e saj, Gjykata theksoi se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur propozimin e tij ku *“pas 1 viti, 10 muajve dhe 8 ditëve, Gjykata refuzoi padinë private dhe pushoi procedurën penale ..., dhe në bazë të nenit 62 par 1 dhe 2, dhe nenit 316 par. 2 të KPPK-së”*. Parashtruesi i kërkesës nuk e kontestoi këtë Aktvendim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë arrestimit ai ishte rrahur nga 4 (katër) oficerë të policisë dhe si pasojë, ai kishte pësuar lëndime të rënda të trurit. Ai gjithashtu deklaroi: *“Unë Rrok Nikoll Penkaj, sipas mundësive kam vazhdue me kallxim penal, por Gjykata kishte pushue rastin dhe per arsye shendetsore se kisha kuptue...”*.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”.

22. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

... ”

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi... ”.

23. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata gjen se parashtruesi parashtrroi kërkesën e tij më 28 gusht 2014, ndërsa vendimi i fundit i Gjykatës Komonale të Gjakovës (P. nr. 389/12) ishte nxjerrë më 21 gusht 2012, dhe i është dorëzuar atij më 21 qershor 2013.
24. Prandaj, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) Rregullores së punës.
25. Gjykata përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1), (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih, rastin *O'Loughli dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).
26. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani